



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT

Nr. 21264/prot.

Tiranë, më 18.11.2022


Lënda: Dërgohet Udhëzimi "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 " Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit ".

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BORXHIT PUBLIK DHE
BASHKËRENDIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT

Mbështetur në pikën 4. të nenit 102, të Kushtetutës, dhe në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bashkëlidhur iu dërgojmë udhëzimin nr. 31, datë 18.11.22 "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit ", të ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,





18.11.2022

UDHËZIM

21264

Nr. 31 datë 18.11.2022

“PËR

**NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 9, DATË 20.03.2018 ‘PËR PROCEDURAT
STANDARTE TË ZBATIMIT TË BUXHETIT’, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4. të nenit 102. të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 9936. datë 26.06.2008. “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë:

UDHËZON

Në Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”. bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 78. shtohet gërma “f”. me këtë përmbajtje:

“f”. Për kryerjen e pagesave për shërbimin e borxhit të përcaktuara në germën “g”. të pikës 59. të këtij udhëzimi”.

2. Paragrafi i fundit i pikës 78. zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

“Transferimet e fondeve të pashpërndara sipas pikës (a), të këtij paragrafi bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe zbatohen me kërkesë të nëpunësit autorizues të njësisë qendrore dhe miratim të Nëpunësit të Parë Autorizues. Të gjitha përdorimet e fondeve sipas pikës (d) bëhen me kërkesë të nëpunësit autorizues të njësisë së qeverisjes qendrore dhe miratim të Ministrit përgjegjës për Financat. Të gjitha rialokimet brenda zërave për “shërbimet e borxhit”, sipas pikës “f” miratohen nga Ministri përgjegjës për Financat. Me miratim të Nëpunësit të Parë Autorizues kryhen transferimet sipas pikave (b), (c) dhe (e).”

3. Udhëzimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

MINISTËR

Delina Ibrahimaj

